



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 30 mars 2015, në mbledhjen e XV-të
(pesëmbëdhjetë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 14.00’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Afrim Shabani, Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Haki Rudari, theksoi, është hera e dytë apo e tretë që kam kërkuar që në rend dite të përfshihet Informata e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim, me qira, të pronës komunale përkatësisht objekteve ish Hotel “Llapi” dhe ish SHKSH, kam pritur që kjo çështje do të jetë në rend dite të mbledhjes së sotme por kjo nuk ka ndodhur, andaj këtë kërkesë e përsërisë dhe kërkoj që të përfshihet në rend dite të mbledhjes së sotme.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, lidhur me çështjen të cilën e ngriti z. Haki Rudari, jam i informuar se drejtori i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë e ka përgatitur informatën përkatëse dhe të njëjtën para fillimit të mbledhjes së nesërme të Kuvendit do t’ia dorëzoj të përmendurit.

z. Haki Rudari, theksoi, unë kam kërkuar që informata përkatëse të përfshihet në rend dite e jo vetëm të më jepet në formë të shkruar vetëm mua.

Rendi i propozuar i ditës u miratua me shumicë votash përkatësisht 9 vota për, 1 votë kundër dhe asnjë votë të përmbajtur.

2. Shqyrtimi i Ekstrakteve të procesverbaleve të mbajtura në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa më 2 shkurt 2015 dhe 26 shkurt 2015

Ekstraktet e procesverbaleve u miratuan njëzëri, me korrigjim të Ekstraktit të datës 2 shkurt 2015, në faqen e pestë përkatësisht në diskutimin e z. Haki Rudarit ku thuhet “ Muharrem Rudari “ i cili ka qenë profesor ” e duhet të jetë “ i cili ka qenë luftëtar i Luftës Nacional Çlirimtare në vitin 1945”.

Në mungesë të drejtorëve të Drejtorive, u vendos që të vazhdohet me pikën e rendit të ditës në vijim, me mbështetje të diskutimit të z. Naim Çunakut, i cili tha se drejtorëve të Drejtorive duhet t’iu tërhiqet vërejtja që të mos vonohen në mbledhjet e këtij Komiteti, përndryshe nëse përsëritet një veprim i këtillë, çështjet nuk do të shqyrtohen përkatësisht Kuvendit nuk do t’i propozohen rekomandimet përkatëse.

3. Draft Strategjia Komunale për Informim dhe Komunikim 2015-2018

- Propozimi i vendimit për vënie në diskutim publik

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, jemi në dijeni se ky material në fazën e tanishme është draft që do të thotë se nuk është në fazën finalizuese dhe duke u bazuar se do të vihet në diskutim publik kemi kohë të mjaftueshme që t’i paraqesim vërejtjet dhe plotësimet konkrete. Përndryshe e mbështes plotësisht këtë dokument dhe konsideroj se jo vetëm komuna e jonë por të gjitha komunat tjera janë vonuar për miratimin e kësaj Strategjie.

z. Naim Çunaku, theksoi, në radhë të parë jam i interesuar të di se strategjitë a kanë nevojë të vihen në diskutim publik, andaj për këtë kërkoj sqarime.

Së dyti, kjo Strategji e ka një kosto financiare por mjetet buxhetore nuk janë të planifikuara, pra me buxhet nuk ka mjete për këtë destinim.

Së treti, në këtë draft Strategji në shumë vende çështjet përsëriten, gjithashtu në shumë segmente siç janë Kuvendi, Komitetet, Drejtoritë etj. thuhet se duhet të kenë zëdhënësin e vet, këtë materie e rregullon Rregullorja për transparencën e Institucioneve komunale sipas së cilës Zyra e Informimit është ajo e cila i përcjell punët e institucioneve të Komunës dhe informacionet përkatëse i bënë publike.

Krejtësisht në fund, kur numërohen resorët dhe mënyra ndërlidhëse e tyre me Zyrën e Informimit, në radhë të parë janë Drejtoritë Komunale e në fund është Kuvendi i Komunës, kjo renditje do duhej të jetë e kundërta andaj duhet korrigjohen në mënyrë që së pari të jetë Kuvendi i Komunës.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, lidhur me çështjen të cilën e shtroi parafolësi për atë se kjo draft Strategji a duhet të vihet në diskutim publik apo jo, për këtë çështje jam konsultuar me Zyrën ligjore e cila është e mendimit se duhet të vihet në diskutim publik, mirëpo edhe praktika e komunave të tjera por edhe rekomandimi i OSBE – së është se duhet të vihet në diskutim publik.

z. Kadri Avdiu, theksoi, në praktikën e deritashme strategjitë nuk janë vënë në diskutim publik, mirëpo a është kjo praktikë e re nuk jam në dijeni. Gjithashtu sipas kësaj Strategjie rezulton se të gjithë sektorët e kanë nga një zyrtar për informim derisa ne jemi në dijeni se Zyra e Informimit është kompetente për publikimin e të

gjitha informacioneve duke filluar prej punëve të Kryetarit të Komunës, Kuvendit dhe institucioneve tjera.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, në çdo sektor të institucioneve të Komunës caktohet nga një zyrtar i cili e njofton Zyrën e Informimit për punët e kryera në sektorin përkatës në mënyrë që informacionet të janë të janë pasqyrë e qartë dhe sa më transparente për punët e kryera.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim me plotësim që debati publik të zgjat 15 ditë, ndërsa debati me qytetarë të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës më 15 prill 2015 në orën 14;00.

4. Raporti financiar për vitin 2014

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financa, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Haki Rudari, theksoi, vlen të theksohet se e mira është që buxheti është shpenzuar 95.22% dhe mund të themi se është përqindje e kënaqshme, mirëpo për mua nuk është në rregull se gjatë periudhës nëntëmujore shpenzimet në investime kapitale kanë qenë 35%, ndërsa në tremujorin e fundit kemi rritje enorme të shpenzimeve, andaj për këtë kërkoj sqarime përkatëse.

Në kode të ndryshme janë disa rritje të shpenzimeve ku mbi të gjitha janë investimet e mëdha në kanalizime, rrugë dhe infrastrukturë tjetër, mirëpo vërehet se cilësia e punimeve nuk është në nivel e për këtë kam ankesa të qytetarëve por edhe në disa raste jam bindur personalisht siç është rasti i rrugëve “ Xhafer Meta “ e “ Besnik Restelica “ ku ujërat e zeza hyjnë në oborre e shtëpi, pra kjo është pasojë e cilësisë jo të mirë të punimeve të kanalizimit.

Gjithashtu për asfaltimin e rrugëve bëhen shpenzime të mëdha por cilësia e punimeve është e dobët e kjo më së miri vërehet në rrugën “ Zahir Pajaziti “ prej Hotel Besianës deri te Shkolla e Mesme e Lartë Ekonomike.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, në këtë raport mua më së tepërmi më ka lënë përshtypje ndryshimi i projekteve prioritare përkatësish fakti se janë përfshirë projekte të cilat nuk kanë qenë në prioritet.

Te investimet kapitale vetëm për asfaltimin e rrugëve janë investuar 2. 838.000 €, kjo është shumë e madhe dhe afërsisht të gjithë jemi në dijeni se sa km. rrugë mund të shtrohen me këtë shumë dhe me çfarë cilësie, andaj unë kërkoj sqarime se sa km. rrugë janë asfaltuar me shpenzimet e cekura. E njëjta çështje është edhe me ndërtimin e trotuareve në shumë prej 281.000 €, derisa për gjendjen e tyre jemi në dijeni të gjithë. Përshtypje më ka lënë edhe çështja e pajisjeve speciale mjekësore në vitin 2014 që është në shumë 45.000 €, lidhur me këtë vitin e kaluar kam qenë i interesuar të di se cilat janë ato pajisje speciale në kuadër të QKMF-së në Podujevë, por përgjigje nuk kam marrë. Këtë e them ngase në një rast personal për nevoja të një të afërmi tim kam qenë i detyruar të blejë fashë për mbështjelljen e varrës.

Gjithashtu nuk është në rregull çështja e shpenzimeve për pagesat gjyqësore që janë në shumë mbi 200.000 € e kjo do të thotë se qeverisja komunale po ndërmerr veprime në kundërshtim me ligjin.

z. Fidan Rekalii, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve i LDK – së konsiderojmë se Raporti financiar është punuar dhe hartuar në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe se shpenzimet janë bërë në kuadër të planifikimeve të Komunës.

z. Kadri Avdiu, theksoi, Raporti për të cilin po debatojmë është mjaftë i gjerë, mirëpo unë jam i mendimit se sa më i shkurtë me qenë është më i qartë dhe më i kapshëm për ne këshilltarët e Kuvendit.

z. Naim Çunaku, theksoi, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, në fjalën hyrëse, tha se ka parë raporte më të shkurta të cilat nuk kanë qenë të detajizuara si Raporti për të cilin jemi duke debatuar, lidhur me këtë me qëllimin më të mirë them se kam pasë rastin dhe kam parë raporte të një komune, të jeni të bindur, të cilat kanë qenë shumë më voluminoze, kam parë raporte ku janë paraqitur të dhëna për çdo burim buxhetor dhe atë kush i ka shpenzuar dhe ku janë shpenzuar mjetet përkatëse buxhetore.

Në rastin konkret e marrim shembull Zyrën e Kryetarit të Komunës në të cilën zhvillohen shumë aktivitete, Zyrë në të cilën janë shpenzuar mjete në shumë mjaftë e madhe, mirëpo sikur t'i kishim pasë të dhënat se prej cilit burim janë marrë dhe kush i ka shpenzuar mjetet atëherë do të ishte më e qartë ngase në mënyrën e paraqitur ndokush e merr se këto shpenzime janë vetëm të Kryetarit të Komunës.

Vërejtja kryesore e imja është te të hyrat vetanake, jam në dijeni se në aspektin e arkëtimit jemi afërsisht si komunat tjera të Kosovës, mirëpo sa i përket arkëtimit të të hyrave vetanake nga dhënia me qira të pronës komunale kemi ngecje dhe shtrohet nevoja për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve për përmirësimin e gjendjes në këtë segment.

Për mua është e pakuptueshme kur një person konkurren dhe e merr në shfrytëzim pronën komunale dhe paraprakisht është i përgatitur për obligimet financiare që i merr përsipër ndaj komunës dhe të mos i përmbush obligimet përkatëse financiare, po e përsërisë kjo për mua është e pakuptueshme, andaj konsideroj se në të ardhmen do duhej të na paraqitet një pasqyrë për shfrytëzuesit e pronës komunale dhe përmbushja e obligimeve të tyre financiare ndaj Komunës, me të vetmin qëllim që atyre personave t'u shkëputet kontrata apo të gjendet ndonjë formë që ata t'i përmbushin obligimet ndaj Komunës.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, sa i përket dinamikës së shpenzimeve të buxhetit tremujori i fundit i vitit është periudha kur bëhet përfundimi i punimeve, pranimet teknike dhe kuptohet bëhen edhe pagesa përkatëse, e kjo ka të bëjë më së shumti me investime kapitale përkatësisht në asfaltimin e rrugëve dhe ndërtimin e kanalizimeve.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, sa i përket ndërtimit të trotuareve mund të them se punimet janë bërë mbi dhjetë rrugë dhe përfshijnë mbi 6000 m² sipas kontratës dyvjeçare. Çështja përse pagesat janë koncentruar në tremujorin e fundit nuk ka të bëjë me atë se projektet janë realizuar në periudhën e cekur por për atë se jeni në dijeni që e kemi bërë rishikimin e buxhetit të Komunës, mirëpo për shkak të mos konsolidimit të Kuvendit të Kosovës ai rishikim nuk është miratuar dhe në atë kohë kemi pasë punë të kryera të papaguara por pagesat nuk kanë mund të kryhen derisa është miratuar ridestinimi mjeteve përkatëse.

Pas votimit u konstatua se me 10 vota për, asnjë kundër dhe 1 votë të përmbajtur, Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim.

5. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

- **Informatë për aktivitetet në vitin 2014**
- **Plani vjetor i punës në vitin 2015**

z. Faik Muçiqi, koordinator i KKSB –së e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Haki Rudari, theksoi, sipas aktit nënligjor me të cilin rregullohet puna e këtij Këshilli, parashihet që i njëjti t'i raportoj Kuvendin të Komunës së paku dy herë brenda vitit dhe përkundër kërkesës tonë kjo nuk është marrë në konsideratë.

Në mbledhjen e tretë të mbajtur më 02.09.2014 është bërë një informim i KKSB – së për opinion ku ndër të tjera thuhet se në Komunën e Podujevës gjatë vitit 2014 nuk ka ndodhë asnjë rast vrasjeje, lidhur me këtë nuk jam në dijeni se a është çështje e harresës apo diç tjetër, mirëpo kemi pasë një rast vrasjeje në kufirin Kosovë – Serbi, rast për të cilin kemi kërkuar informatë nga KKSB por nuk kemi marrë kurrfarë përgjigje.

z. Fidan Rekalju, theksoi, është e vërtet se në territorin e Komunës së Podujevës gjatë vitit 2014 nuk ka ndodhë asnjë rast vrasjeje, është fakt se fatkeqësisht ka ndodh një rast vrasjeje të një qytetari të Komunës tonë përkatësisht të fshatit Llaushë, që e përmendi parafolësi, mirëpo ky rast nuk ka ndodhë në territorin e Komunës së Podujevës, e kjo nënkupton se në Komunën e Podujevës, në vitin 2014, nuk ka pasë asnjë rast vrasjeje, e ky fakt na gëzon të gjithë neve.

z. Haki Rudari, theksoi, sipas Kushtetutës, Kryetari i Komunës duhet të interesohet për të gjithë qytetarët e Komunës, lidhur me rastin konkret nuk kemi informatë zyrtare andaj nuk mund të themi se vrasja a ka ndodh në territorin e Republikës së Kosovës apo në territorin e Serbisë.

z. Kadri Avdiu, theksoi, rasti për të cilin po debatohet ka ndodh në zonën kufitare të Kosovës dhe Serbisë, në bazë të kësaj informacionet përkatëse i kanë pasë Institucionet qendrore të Kosovës dhe KFOR – i, pra kjo nuk ka qenë çështje e nivelit lokal e në këtë kuptim dihet se Kryetari i Komunës mund të ketë pasë informacione jo të plota.

Konsideroj se KKSB është dashtë të ketë parasysh se në Komunën e Podujevës vepron Këshilli i Pajtimit i cili, ditë dhe natë, merret me ndërmjetësimin e palëve të cilat janë në konflikte dhe ngatërresa dhe falë ndërhyrjes së menjëhershme dhe angazhimit të atij Këshilli janë minimizuar mospajtimet e palëve të ndryshme e fatbardhësisht viti 2014 ka përfunduar pa asnjë vrasje në territorin e Komunës së Podujevës. Në këtë kontekst konsideroj se në Informatën për të cilën jemi duke debatuar do duhej të përfshihej edhe puna, angazhimi dhe kontributi i Këshillit të cekur, por gjithashtu ai Këshill, në vitin 2015, të mbështetet në forma të ndryshme.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, jam në dijeni se Ekzekutivi i Komunës e ka marrë një vendim për eliminimin e qenve endacak, mirëpo i njëjti është shfuqizuar ngase ka qenë në kundërshtim me dispozita ligjore për shkak se qenët endacak mund të trajtohen në mënyrat përkatëse e jo të eliminohen. Lidhur me këtë jam i interesuar të di se a është hartuar ndonjë plan rreth kësaj çështjeje që është preokupuese jo vetëm për Komunën e Podujevës por edhe më gjerë, andaj konsideroj se KKSB – ja do duhet të ketë një plan konkret për trajtimin e qenve endacak në mënyrë që të mos pëson ndokush.

z. Faik Muçiqi, theksoi, sipas dispozitave ligjore, në rastet e rrezikshmërisë, lejohet edhe eliminimi i kafshëve të egra dhe qenve endacak, mirëpo thuhet me

më pak dhembje. Përndryshe në territorin e Komunës tonë është një numër mjaftë i madh e qenve endacak dhe për trajtimin e tyre sipas dispozitave ligjore kërkohen mjete të shumta financiare të cilat Komuna nuk ka mundësi me i siguruar.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, konsideroj se në funksion të zbatimit të dispozitave ligjore për zgjidhjen e problematikës së qenve endacak, në kuadër të partneritetit, do duhej të përfshihet edhe Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës me qëllim që kjo çështje të trajtohet në mënyrë profesionale.

z. Kadri Avdiu, theksoi, bazuar në dispozitat ligjore trajtimi i qenve endacak parashihet sipas standardeve perëndimore, mirëpo dihet se ato shtete i kanë edhe kushtet edhe mundësitë për të vepruar në atë mënyrë, mirëpo ne nuk i kemi as kushtet e as mundësitë për trajtimin e tillë të qenve, por gjithsesi në koordinim të të gjitha institucioneve duhet të gjendet mënyra dhe forma për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim, me konstatim se qenët endacak paraqesin shqetësim për Institucionet dhe qytetarët e Komunës dhe duke u bazuar në rrezikshmërinë evidente, në pajtim me dispozitat ligjore, në bashkëpunim me Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe subjektet tjera relevante, në kuadër të Planit të punës të përcaktohen veprimet konkrete për zgjidhjen e kësaj çështjeje

6. Propozimi i Vendimit për iniciimin e procedurës për hartimin e propozimit të korrigjimeve të Planit Rregullues Urban “ Zona Qendër “ në Podujevë

z. Durim Salihu, Ushtrues i detyrës së drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban, Mbrojtjes dhe Mjedisit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, vendimi përkatës është miratuar sipas ligjit të vjetër e tash në fuqi janë dispozitat e reja ligjore të cilat jemi të obliguar t'i zbatojmë, përndryshe korrigjimet teknike do t'i bëjë Drejtoria kompetente, mirëpo kuptohet se paraprakisht Kuvendi duhet të miratoj vendimin që të bëhen korrigjimet përkatëse.

z. Haki Rudari, theksoi, në Vendimin e Inspektoratit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor thuhet, në pikën 2, thuhet “ Të mos miratoj Plane Rregulluese Urbane që janë në kundërshtim me nenin 15 të Ligjit... dhe neneve 2 e 3 të Udhëzimit administrativ..., andaj në këtë kontekst duhet të kemi kujdes që të mos biem në kundërshtim me dispozita ligjore.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

7. Propozimi i Vendimit për iniciimin e procedurës për revidimin e Planit Detaj Urbanistik të kompleksit Podujeva II

z. Durim Salihu, Ushtrues i detyrës së drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban, Mbrojtjes dhe Mjedisit, e paraqiti fjalën hyrëse.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

8. Rishqyrtimi i Vendimit për themelimin e Teatrit Publik të qytetit të Podujevës

z. Agron Gërguri, i autorizuar për të ushtruar kompetencat e drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, vendimi për themelimin e Teatrit Publik, i miratuar në vitin 2012, në procedurën e vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, është vlerësuar se nuk prodhon efekt juridik për shkak se në atë kohë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk e kishte nxjerrë aktin nënligjor me të cilin do të përcaktohej më afërsisht mënyra e themelimit të teatrove, mirëpo meqë pak kohë më parë është nxjerr ai akt nënligjor duhet të kemi kujdes që Teatri Publik të themelohet në pajtim me të njëjtin.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

9. Propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (Sipas kërkesës të Arif Arifit nga Podujeva)

z. Durim Salihu, Ushtrues i detyrës së drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban, Mbrojtjes dhe Mjedisit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Naim Çunaku, theksoi, në parim në rastet e këtilla asnjëherë nuk kemi qenë kundër që ndokujt t'ia kufizojmë të drejtën e disponimit të lirshëm të pronave të tyre, andaj edhe ky rast është në vazhden e rasteve të mëparshme, pra pajtohem me këtë propozim të vendimit.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 14.50 '

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-39122
Podujevë,
30 mars 2015**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**